



Newsletter

STRONG ALBANIAN LOCAL STATISTICS

Tetor 2024 - mars 2025

Projekti "Statistika të Forta Vendore Shqiptare" (SALSTAT II) është pjesë e nismës "Bashki të Forta", financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) që zbatohet në periudhën tetor 2022 - shtator 2026.

Palët kyçe të interesit të projektit SALSTAT, përfshijnë INSTAT-in, bashkitë, si dhe disa ministri të linjës e agjenci qeveritare, veçanërisht ato të përfshira mbledhjen e të dhënave statistikore dhe/ose përgjegjëse për të dhënat dhe regjistrat administrativë.

Gjatë kësaj faze të re, SALSTAT II do të thellojë bashkëpunimin me bashkitë dhe agjencitë e tjera qeveritare me qëllim mëkimin e besimit në statistikat zyrtare. Gjithashtu, projekti do të angazhojë palët e interesit në lidhje me rëndësinë e statistikave zyrtare për qeverisjen demokratike dhe vendimmarrjen e informuar, veçanërisht duke mbështetur bashkitë në përmbushjen e detyrave dhe funksioneve të tyre, dhe me vendimmarrjen veçanërisht në kuadër të përmbushjes së detyrave dhe funksioneve të bashkive.

Përmbajtja:

- Zhvillimi i konceptit të shpërndarjes digjitale të publikimit të të dhënave statistikore për qarqet dhe bashkitë, duke siguruar qasje në të gjitha burimet e të dhënave;
- Shkëmbimet me palët e interesit për krijimin e besimit lidhur me statistikat në nivel vendor;
- Grupi i punës INSTAT/SALSTAT dhe Ministrisë së Shtetit për Vetëqeverisjen Vendore;
- Regjistri Statistikor Shqiptar i Godinave dhe Banesave;
- Vijimi i trajnimeve të rregullta në fushën e statistikave të mbetjeve për shpjegimin e instrumenteve për mbledhjen e të dhënave, përmbajtjen dhe metodat që do të zbatohen për bashkitë;
- Statistikat e Arsimit Parashkollor në nivel bashkie;
- Statistikat e pyjeve (fushë e re statistikore);
- Trajnim për stafin e INSTAT-it mbi metodologjitë e reja të anketimeve me kampionim për përfaqësuesit në nivel qarku dhe vendor;
- Forumi Kombëtar për Demokraci Vendore; Qeverisje e Mirë Vendore: Transparenca dhe Llogaridhënia në Vendimmarrje;
- Mbështetja e ngritjes së statistika Jetësore të lindjes, vdekjes, etj.;
- Trajnimi për personelin e ri të INSTAT-it dhe për personelin e Zyrave Rajonale Statistikore të INSTAT-it.

Zhvillimi i konceptit të shpërndarjes digjitale të publikimit të të dhënave statistikore për qarqet dhe bashkitë, duke siguruar qasje në të gjitha burimet e të dhënave

Ekipi i GIS-it ka punuar ngushtë me ekspertët për ngritjen e platformës së TI-së të bazuar në internet (paneli) për shpërndarjen e sigurt të të dhënave dhe përfshirjen e tyre në faqen e internetit të INSTAT-it për shpërndarje miqësore dhe të përditësuar të të dhënave të Censit 2023 dhe për statistikën për qarqet dhe bashkitë në INSTAT.







Nyja e të dhënave (DataHub) e INSTAT-it është platformë e zhvilluar nga Instituti i Statistikave (INSTAT) i Shqipërisë për të siguruar qasje në të dhëna statistikore dhe gjeohapësinore. Ajo shërben si vendgrumbullim për statistika zyrtare, duke u mundësuar kërkuesve, politikëbërësve, dhe publikut të eksplorojnë, analizojnë dhe shkarkojnë të dhëna për sektorë të ndryshëm si demografia, ekonomia, arsimi, shëndetësia dhe shumë të tjerë.

Platforma është projektuar të nxisë transparencën dhe vendimarrjen e informuar përmes ofrimit të informacionit statistikor të besueshëm, miqësor me përdoruesin dhe të përditësuar.

Nga data 03 deri më 07 dhjetor 2024, ekipi i GIS-it të INSTAT mori pjesë në trajnimin: "Shpërndarja e të dhënave gjeohapësinore dhe Statistikave Rajonale të Censit".

Lidhësi PxWeb është instrument ose integrim që lehtëson nxjerrjen dhe transferimin e të dhënave statistikore nga PxWeb-i, platformë që përdoret rëndom nga agjencitë statistikore për publikimin e statistikave zyrtare.



INSTAT-i vijoi të popullojë Nyjën e të Dhënave Gjeografike (Geo-Data Hub) (panel) me të dhëna nga Censi dhe të dhëna nga Vjetari Rajonal. Për më tepër, ka vijuar puna për zhvillimin dhe përsosjen e mëtejshme të panelit. Pritet që varianti përfundimtar të jetë i disponueshëm në qershor të vitit 2025.

Shkëmbimet me palët e interesit për krijimin e besimit lidhur me statistikat në nivel vendor

Në periudhën 11 nëntor deri 21 nëntor 2024, u organizuan vizita në terren me ekspertin, për qëllime monitorimi dhe vlerësimi. Vizitat u kryen në bashkitë Kavajë, Gjirokastrë, Përmet, Korçë, Përrenjas, Librazhd, Maliq dhe Pogradec.

Qëllimi i vizitave kishte të bënte drejtpërsëdrejti me Rezultatit 3 të Projektit SALSTAT: Bashkitë mbështeten për ngritjen e aftësive dhe kapacitetet të veta statistikore dhe tregojnë ndërgjegjësim më të madh lidhur me rolin e statistikave zyrtare në Shqipëri.

Produktet e Veçanta të Trajtuar:

- **3.1:** Zhvillimi i rregullt i trajnimeve dhe seminareve për ngritjen e kapaciteteve për bashkitë si ofrues të dhënash.
- **3.2:** Zhvillimi i rregullt i trajnimeve dhe seminareve për ngritjen e kapaciteteve për bashkitë si përdorues të dhënash.
- **3.3:** Ka nisur shkëmbimi ndërmjet palëve të interesit për përmirësimin e botëkuptimit dhe ritjes së besimit lidhur me statistikat zyrtare.

Gjatë vizitave, eksperti intervistoi personelin bashkiak, dhe më pas hartoi raportin përkatës (dorëzuar SDC-së). Përfundimet e raportit janë si vijon:

Vizitat e monitorimit dhe vlerësimit në tetë bashkitë në fjalë siguruan informacion me vlerë për zbatimin dhe ndikimin e nismave të SALSTAT-it për ngritjen e kapaciteteve. Ekipi takoi ballë për ballë zyrtarët bashkiakë dhe pati mundësi të vlerësojë efektshmërinë e programeve të trajnimit, si dhe të kuptojë vështirësitë vendore lidhur me mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave.

Bashkitë shprehën vlerësim të lartë për seancat e personalizuara të trajnimit, veçanërisht për ato që u përqendruan në statistikat për arsimin parashkollor, lejet e ndërtimit, dhe menaxhimin e mbetjeve, të cilat kanë përmirësuar botëkuptimin e tyre për rolin e statistikave zyrtare në vendimmarrje. Megjithatë, nga të gjithë u ngrit kërkesa për vijim të trajnimeve në Microsoft Excel, me qëllim përforcimin e aftësive praktike.

Pavarësisht rezultateve pozitive, ka ende vështirësi të vazhdueshme, si lëvizja e shpeshtë e personelit, dhe mungesa e roleve të përkushtuara për statistikat në bashki. Këto probleme ndikojnë ndjeshëm qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e përpjekjeve për ngritjen e kapaciteteve.

Reagimet e mbledhura theksojnë rëndësinë e veprimeve ndjekëse me qëllim sigurimin e ndikimit afatgjatë të ndërhyrjeve të SALSTAT-it. Zyrtarët theksuan nevojën për trajnim të posaçëm për statistikat vendore të Censit të vitit 2023, me qëllim përmirësimin e aftësive të tyre për analizimin dhe zbatimin e të dhënave për qëllimet e qeverisjes dhe planifikimit. Për më tepër, bashkitë kërkuan mbështetje më të strukturuar për zbutjen e ndikimeve nga ndryshimet e shpeshta të

personelit, si ngritjen e një arkivi njohurish apo hapjen e roleve më të qëndrueshme dhe të përkushtuara për punën me statistikat.

Këto masa ndjekëse janë thelbësore për sigurimin e rezistencës institucionale dhe ruajtjen e progresit të arritur për përmirësimin e njohurive statistikore dhe vendimmarrjen e bazuar në të dhëna në nivel vendor.

Këto vizita ishin tejet me vlerë për forcimin e marrëdhënieve me zyrtarët bashkiakë, dhe ofruan një platformë për reagime të strukturuar, çka mundëson përshtatjen e ndërhyrjeve të ardhshme sipas nevojave vendore. Ekipi i monitorimit mori informacion të hollësishëm përmes angazhimit të drejtpërdrejtë, njohuri që nuk do të ishin të mundura përmes metodave të vlerësimit në distancë, çka rritet rëndësinë e ndërveprimit ballë për ballë me qëllim krijimin e besimit, nxitjen e bashkëpunimit, dhe arritjen e përparimit kuptimplotë.



Grupi i punës INSTAT/SALSTAT dhe Ministrisë së Shtetit për Vetëqeverisjen Vendore

Më 24 dhjetor u organizua një mbledhje ndërmjet grupit të punës së INSTAT/SALSTAT dhe Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore. Diskutimet u përqendruan në trajnimet për arsimin parashkollor dhe lejet e ndërtimit të organizuara nga INSTAT/SALSTAT për personelin vendor, me synim mbështetjen e mbledhjes së statistikave në këto fusha përmes anketimeve të bazuara në internet të hartuara nga INSTAT-i.

Gjithashtu, përfaqësuesit e Agjencisë paraqitën veprimtaritë e veta të trajnimit dhe bashkëpunimin e tyre me bashkitë, veçanërisht lidhur me treguesit e performancës.

Ata theksuar planin e rimbursimeve për bashkitë, që përfshin shtatë tregues kyçë:

1. Bujqësinë dhe blegtorinë
2. Arsimin
3. Treguesit socialë
4. Menaxhimin e mbetjeve
5. Gjininë
6. Integritetin
7. Sistemin e matjes së performancës

Në përfundim të mbledhjes u ra dakord të organizohej një mbledhje ndjekëse e grupit të punës. U ra gjithashtu dakord se planet e trajnimit për personelin e bashkisë do të vihen në dispozicion paraprakisht me qëllim shmangien e mbivendosjeve dhe arritjen e bashkërendimit më të mirë. Për më tepër, pjesëmarrësit u angazhuan të shkëmbejnë manualët dhe kurrikulat e trajnimit me qëllim harmonizimin e përpjekjeve dhe nxitjen e vijueshmërisë.

Regjistri Shqiptar Statistikor i Ndërtesave dhe Banesave

Në kuadër të Projektit SALSTAT, INSTAT po zbaton Regjistrin Statistikor të Ndërtesave dhe Banesave (RSHSNB). Gjatë periudhës së raportimit, ekipi i GIS-it i INSTAT-it bashkëpunoi ngushtë me ekspertin e projektit. Në datat 8 dhe 9 janar 2025, u zhvillua seminari hapës i mandatit të dytë të TI-së së RSHSNB-së.

Pjesëmarrësit diskutuan gjendjen aktuale të RSHSNB-së dhe përvijuan hapat e zbatimit për vitin 2025. U theksua se periudha 12 mujore në vijim është kritike për zbatimin me sukses të regjistrit.

U identifikuan përbërësit kyçë ose rrjedhat kyçë të punës si më poshtë:

- Informacioni i Censit për RSHSNB-në dhe integrimi i të dhënave të Censit në regjistrë
- Zhvillimi përfundimtar i aplikacionit të RSHSNB-së
- Zhvillimi i një aplikacioni terreni për mbledhjen e të dhënave dhe mirëmbajtjen.
- Bashkërendimi dhe hartëzimi i të dhënave në kuadër të Regjistrit Kombëtar të Adresave (RKA)


U ra dakord se plani i punës duhet të organizohet me dhënie të qartë përparësie detyrave përkatëse. Synimi është RSHSNB-ja tërësisht funksional përpara përfundimit të vitit, duke mundësuar si zbatimin fillestar dhe mirëmbajtjen e regjistrit në të ardhmen.

Dhënia përparësi nënkupton gjithashtu miratimin e zgjidhjeve pragmatike dhe të zbatueshme, siç theksohen gjatë diskutimeve me RKA-në. Mund të jetë e nevojshme që hapat fillestarë të përqendrohen vetëm një herë në përputhjen e godinave/hyrjeve me adresat e tyre. Tipare më të përparuara si shërbimet e ndërlikuara në internet (web) mund të merren në konsideratë në faza të mëvonshme dhe nuk priten të jenë pjesë e zbatimit fillestar.

Për më tepër, u ra dakord se ka nevojë për një grup të dhënash pilotimi me qëllim mbështetjen e mëtejshme të analizës dhe përsosjes së procesit të përputhjes.

Për shkak të zgjedhjeve të përgjithshme që mbahen së shpejti dhe punës së vazhdueshme të Regjistrit Civil dhe Sistemit të Adresave, procesi i përputhjes së plotë nuk pritet të nisë përpara majit të vitit 2025.

Deri në fund të janarit të vitit 2025, do të përcaktohet plani përfundimtar dhe i hollësishëm i punës. Ky plan do të përfshijë rezultatet e diskutimeve të seminarit dhe do të drejtojë zbatimin e përbërësve kyçë dhe rrjedhave të punës së regjistrit.



Në data 27 dhe 28 janar në INSTAT u zhvillua një mision me ekspertë ndërkombëtarë. Vizita dyditore u përqendrua në disa fusha kyçe që lidhen me zhvillimin e Regjistrit Shqiptar Statistikor të Godinave dhe Banesave (RSHSNB). Pikat kryesore të diskutuara dhe trajtuara gjatë misionit ishin si më poshtë:

1. Përmirësimi i Qasjes për Menaxhimin e Godinave që Mungojnë në Cens

Ekipi hulumtoi metodat për identifikimin dhe integrimin e godinave që nuk u kapën gjatë Censit. Diskutimet u përqendruan në zhvillimin e qasjeve të automatizuara ose gjysmë të automatizuara për përfshirjen e këtyre godinave në bazën e të dhënave gjeografike të regjistrit të ardhshëm.

2. Harmonizimi me Specifikimet më të Fundit të Bazës së të Dhënave Gjeografike dhe Formatin e Ndërmjetëm të të Dhënave

Bazuar në dokumentacionin e përgatitur në vitin 2024, u ra dakord se baza ekzistuese e të dhënave gjeografike duhet të përshtatet me qëllim harmonizimin me specifikimet më të fundit. Janë ende të nevojshme disa sqarime për të kuptuar plotësisht disa elemente të strukturës së re të bazës së të dhënave gjeografike.

3. Planifikimi i Operacioneve për Transferimin e të Dhënave

Për detyrat dhe veprimtaritë e ardhshme të nevojshme për përgatitjen e fazës fillestare të ngarkimit të të dhënave u përcaktuan udhëzimet paraprake. Këto hapa do të përbëjnë themelet e transferimit dhe integritit pa probleme të të dhënave në sistemin e RSHSNB-së.

Vijimi i trajnimeve të rregullta në fushën e statistikave të mbetjeve për shpjegimin e instrumenteve për mbledhjen e të dhënave, përmbajtjen dhe metodat që do të zbatohen për bashkitë

Në shkurt të vitit 2025, Njësia e Mjedisit dhe Pyjeve në INSTAT shpërndau adresën e internetit për Anketën e Mbetjeve Familjare të vitit 2024 në të 61 bashkitë e vendit.

Gjatë marsit, njësia do të kryejë kontrollin e cilësisë për të dhënat e dorëzuara nga bashkitë të cilat kanë plotësuar anketën. Rezultatet përfundimtare priten të publikohen në shtator të vitit 2025.

Deri në fund të marsit të vitit 2025, Njësia e Mjedisit dhe Pyjeve do të informojë projektin SALSTAT lidhur me numrin e bashkive që kanë hasur vështirësi në plotësimin e pyetësorit. Ky informacion do të ndihmojë në përcaktimin e nevojave për mbështetje në terren, për të ndihmuar bashkitë që nuk janë të afta të plotësojnë vetë pyetësorin.

Statistikat e Arsimit Parashkollor në nivel bashkie (fushë e re statistikash):

Në kuadër të përpjekjeve për zgjerimin e treguesve statistikorë vendorë dhe përqafimin e transformimit digjital, SALSTAT në bashkëpunim të ngushtë me INSTAT, hapën programin e trajnimit për mbledhjen e të dhënave statistikore për arsimin parashkollor. Nisma përqendrohet në mbledhjen e të dhënave të çerdheve dhe kopshteve publike në nivel bashkie përmes një platforme të bazuar në internet dhe të zhvilluar nga INSTAT-i.

Aktualisht, INSTAT-i shpërndan vetëm një tregues të lidhur me sistemin parashkollor në nivel vendor: **"Numri i fëmijëve të regjistruar në kopsht për vitin e ri akademik"**. Për çerdhet nuk ka tregues zyrtarë të disponueshëm në nivel bashkie. Objektivi i kësaj nisme është të rrisë numrin e treguesve të mbledhur dhe të shpërndarë në sektorin e parashkollorit (çerdhet dhe kopshtet publike) përmes një sistemi novator, digjital të mbledhjes së të dhënave që përdor një pyetësor në internet.

Me qëllim mbështetjen e këtij synimi, SALSTAT dhe INSTAT organizuan një program trajnimi në tetor të vitit 2024 për përdorimin e platformës për mbledhjen e të dhënave të bazuar në internet për statistikën e parashkollorit. Kjo veprimtari u zbatua në kuadër të:

- **Rezultatit 1.2.1:** Analizimi dhe shpërndarja e treguesve të arsimit parashkollor publik (çerdhet dhe kopshtet) në nivel bashkie.
- **Rezultatit 3.1.4:** Zbatimi i trajnimit për sistemet (e bazuara në internet) të mbledhjes së të dhënave (anketa ose të dhënat administrative) me të 61 bashkitë

Trajnimi trajtoi temat kyçe më poshtë:

- Kuadrin ligjor dhe rëndësinë e statistikave të parashkollorit në nivel bashkiak
- Pyetësorin për çerdhet dhe kopshtet
- Përkufizimet e treguesve dhe metodologjinë për mbledhjen e të dhënave
- Formularin e bazuar në internet për mbledhjen e të dhënave
- Shembujt praktikë për plotësimin e pyetësorit në internet

Seancat e trajnimit u zhvilluan në grupe me përfaqësues nga secila bashki, gjatë periudhës 7-11 tetor 2024. Trajnuesit u morën nga Sektori i Zhvillimit të Statistikave Sociale dhe Departamenti i TI-së në INSTAT.




U trajnuan gjithsej **77 punonjës bashkiakë** nga **50 bashki**. Nga këta, **59 pjesëmarrëse (80%) ishin gra**. Në përgjithësi, trajnimi mbuloi **82% të të gjitha bashkive**, çka përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt zbatimit të mbledhjes së të dhënave digjitale për parashkollorin në rang kombëtar.



Gjatë javës së **13 deri 17 janar 2025**, një ekip i Drejtorisë së Statistikave Sociale së bashku me trajnuesit e seancave të tetorit, dhe me mbështetjen e koordinatoreve, organizuan vizita në bashkitë e mëposhtme: Dimal, Fier, Has, Himarë, Klos, Konispol, Memaliaj, Skrapar, Tepelenë, dhe Vlorë. Këto bashki kërkuan mbështetje shtesë për shkak të vështirësive me mbledhjen e të dhënave të plota dhe të sakta, kryesisht shkaktuar nga mungesa e burimeve të përshtatshme financiare dhe administrative.

Si pasojë, doli në pah nevoja për trajnim të dytë. Ky trajnim i dytë u përqendrua në ofrimin e shpjegimeve të hollësishme të treguesve financiarë që do të mbledheshin, si dhe metodave dhe vendndodhjeve për marrjen e të dhënave të nevojshme. U rekomandua që për këta tregues të përfshihen specifikime më të hollësishme në manual.

Pas këtyre trajnimeve në terren, të gjitha të dhënat e nevojshme u dorëzuan me sukses nga bashkitë. INSTAT ka konfirmuar marrjen e të dhënave në fjalë.



Statistikat e pyjeve (fushë e re statistikore)

Në kuadër të veprimtarisë **1.2.3** - "Ngritja e infrastrukturës për mbledhjen e të dhënave dhe qarkullimin e të dhënave (nëse është e mundur, me mënyra efikase dhe të efektshme të mbledhjes së të dhënave të bazuara në internet) për statistika" dhe **1.2.3.4** - "Statistikat e pyjeve", më **19 shkurt 2025** u organizua një mbledhje fillestare me Agjencinë Kombëtare të Pyjeve (AKP).

Gjatë mbledhjes, drejtori i AKP-së bëri një paraqitje të veprimtarisë së agjencisë, e cila është ngritur me **Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 570**, datë **17 korrik 2019**, "Për Ngritjen, Organizimin dhe Funkcionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve". Drejtori diskutoi arritjet e agjencisë si dhe vështirësitë që janë hasur. Ai shpjegoi se AKP-ja bashkëpunon me të **61 bashkitë e vendit** dhe shprehu gatishmëri të madhe për bashkëpunimin me INSTAT dhe projektin SALSTAT në fushën mbledhjes së të dhënave pyjore dhe kullosore në nivel bashkiak. Agjencia shprehu interes të madh për të kuptuar se si Agjencia Kombëtare e Pyjeve mund të japë kontribut bazuar në përvojën zvicerane.

Përfaqësuesit e INSTAT-it theksuan synimet e veprimtarisë në fjalë të mbështetur nga projekti SALSTAT, dhe theksuan më tej rëndësinë e bashkëpunimit me AKP-në për mbledhjen e statistikave pyjore dhe kullosore në nivel bashkie.

Në mbyllje të takimit u ra dakord se personeli i INSTAT-it dhe AKP-së do të përmbyllin një projekt pyetësor për pilotim testimi në disa bashki. Ky proces do të zbatohet në bashkëpunim me personelin e AKP-së sipas kërkesës së drejtorit, me qëllim harmonizimin dhe lehtësimin e procesit të mbledhjes së të dhënave. SALSTAT dhe INSTAT shprehën mbështetjen e tyre të plotë për përfshirjen e AKP-së në këto përpjekje.



Gjatë periudhës 24-28 shkurt 2025, ekipi i projektit me një ekspert organizoi një Vizitë Monitorimi dhe Vlerësimi në Terren për të dhënat pyjore dhe kullosore në bashkitë: Klos, Burrel, Bulqizë, Peshkopi, Shkodër, Lezhë, Malësi e Madhe, Elbasan, Librazhd, Përrenjas, dhe Korçë.

Qëllimi i këtyre takimeve ishte angazhimi me bashki të ndryshme për mbledhjen e reagimeve të tyre lidhur me procesin. Në veçanti, synojmë të vlerësojmë:

- Botëkuptimin e tyre lidhur me rolin që luajnë në këtë nismë.
- Gatishmërinë e tyre për të ndërmarrë përgjegjësinë e plotësimit të pyetësorit të pyjeve përpara fundit të marsit.



Gjatë periudhës **17-20 mars 2025**, një ekip i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Mjedisit të INSTAT i mbështetur nga koordinаторët e SALSTAT-it organizuar vizita në bashkitë e mëposhtme: **Tepelenë, Përmet, Këlcyrë, Fier, Roskovec, Kukës, Tropojë, Mirditë, dhe Kurbin.**

Në çdo bashki, në takime morën pjesë personeli që punon në Drejtoritë e Pyjeve dhe Kullotave. Personeli i INSTAT-it shqyrtoi të gjithë pyetësin me ekipet e bashkive, duke marrë shënime lidhur me disponueshmërinë e të dhënave, variablat përkatëse, dhe hollësi të tjera kyçe. Bazuar në këto diskutime do të përgatitet një raport i hollësishëm që do të pasqyrojë gjetjet në kuadër të përmbylljes së project-pyetësorit. Ky project-dokument do t'i dorëzohet më pas Komisionit të Vlerësimit të INSTAT për miratim përpara se t'i kalojë departamentit të TI-së për zhvillimin e platformës së bazuar në internet.

INSTAT-i përfundoi me sukses pilotimin e pyetësorit për mbledhjen e të dhënave pyjore dhe kullimore në nivel bashkie në **9 bashki**: Tepelenë, Përmet, Këlcyrë, Fier, Roskovec, Kukës, Tropojë, Mirditë, dhe Kurbin. Në bashkëpunim me personelin e AKP-së, personeli i INSTAT-it do të përfshijë rregullimet e nevojshme dhe do të përmbyllë pyetësin, duke marrë në konsideratë reagimin e personelit të bashkive që janë përgjegjës për mbledhjen e të dhënave pyjore dhe kullimore.

Varianti përfundimtar i pyetësorit do të miratohet nga Komisioni i Vlerësimit i INSTAT-it, dhe departamenti i TI-së do të vijojë me zhvillimin e pyetësorit dhe adresës së bazuar në internet. Paralelisht do të përgatitet edhe manuali për trajnimin e stafit bashkiak që do të jetë përgjegjës për plotësimin e të dhënave përmes adresës në internet.



Trajnim për stafin e INSTAT-it mbi metodologjitë e reja të anketimeve me kampionim për përfaqësuesit në nivel qarku dhe vendor

Nga data 23 shtator deri më 4 tetor, në ambientet e INSTAT-it u mbajt një trajnim dy javor mbi Statistikat R nga eksperti i Zyrës Federale të Statistikave të Zvicrës për personelin e INSTAT-it. Trajnimi ishte i përbërë nga dy blloqe:

- 1 trajnim për fillestarët gjatë periudhës 23 - 27 shtator;
- 1 trajnim për departamentin metodologjik të INSTAT-it, që është më i përparuar dhe veçanërisht i përqendruar në metodat e kampionimit, gjatë periudhës 30 shtator - 4 tetor 2024.

Temat kryesore që u diskutuan gjatë trajnimit ishin: Bazat e gjuhës R; Kornizat e të Dhënave; vizualizimi i të dhënave, deduksionet statistikore, regresioni; përdorimi i R-së gjatë kampionimit; Trajtimi i mospërgjigjeve' Kalibrimi; Aplikacionet.

25 punonjës gjithsej nga Sektori i Metodologjisë dhe Sektori i Prodhimit Statistikor morën pjesë në trajnim.



Forumi Kombëtar për Demokraci Vendore; Qeverisje e Mirë Vendore: Transparenca dhe Llogaridhënia në Vendimarrje

Më 21 nëntor 2024, ekipi i projektit mori pjesë në Forumin e organizuar në partneritet me Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) dhe me mbështetjen e veçantë të Ministrit të Shtetit për Vetëqeverisjen Vendore, Z. Arbjan Mazniku. Kjo platformë vjetore synon të bëjë bashkë drejtuesit qendrorë dhe vendorë, donatorë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe grupet e interesit me qëllim shkëmbimin e praktikave të mira dhe përf forcimin e rolit të demokracisë vendore në mbarë Shqipërinë.

Gjatë seancës së tretë të forumit: Vendimarrja e Bazuar në të Dhëna, paneli dhe pjesëmarrësit diskutuan për rolin e të dhënave statistikore dhe teknologjisë në vendimarrjen e qeverisjes vendore.

Në panel ishin të pranishëm Znj. Elsa Dhuli, Drejtore e Përgjithshme e INSTAT dhe Z. Martin Teichgraeber, Menaxher Projekti i SALSTAT.



Mbështetja e ngritjes së statistika Jetësore të lindjes, vdekjes, etj.

Trajnimi i organizuar në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet INSTAT/SALSTAT dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGJC, u mbajt nga data 10 deri 13 dhjetor 2024. Trajnimi u organizua me trajnime dy ditore për grup, dhe në të morën pjesë dy grupe me rreth 15 punonjës për grup sipas ndarjes së bërë nga DPGJC-ja të Zyrave të Gjendjes Civile (ZGJC-ve) të Prefekturës së Lezhës.

Seancat e trajnimit 2 ditor ishin informuese dhe produktive. Pjesëmarrësit kuptuan më qartë synimet e INSTAT dhe të DPGJC-së, dhe rëndësinë e statistikave të sakta jetësore dhe të regjistrave administrativë. Ata morën pjesë aktive në diskutime, ndanë përvojat e veta dhe propozuan zgjidhje për përmirësimin e cilësisë së regjistrave jetësorë. Seanca e trajnimit u përmbyll me angazhimin e pjesëmarrësve për të vënë në përdorim njohuritë e marra dhe për të bashkëpunuar me qëllim përmirësimin e procesit të regjistrimit dhe cilësisë së të dhënave në Shqipëri.

Gjatë evidentimit të problemeve me regjistrimin e vdekjeve, INSTAT-i propozoi shpërndarjen e listave me kodet e sëmundjeve dhe përshkrimin e sëmundjeve sipas ICD 9 dhe ICD 10.

Kjo listë, e cila përfshin kodifikimin e sëmundjeve, do të shërbejë si udhëzues për personelin e ZGJC-ve në rastet kur nuk është e mundur të deshifrohet shkaku i vdekjes së përshkruar nga mjeku, por kodit me 3 shifra mund të lexohet qartë sipas klasifikimit. Trajnuesi rekomandon që personeli i Zyrave të Gjendjes Civile të regjistrojnë në fushën e shkakut të vdekjes (që është variabël tekstuale) edhe klasifikimin e ri me kod të IDC10-ës, për shkak të mungesës së zbatimit të klasifikimit të ri në RKGJC.





Trajnimi për personelin e ri të INSTAT-it dhe për personelin e Zyrave Rajonale Statistikore të INSTAT-it

a) Gjatë periudhës 18-19 dhjetor u organizua trajnimi për: TRAJNIMI PËR MICROSOFT 365 ESSENTIAL, për grupin e parë të Zyrave Rajonale të Statistikave. Grupi i dytë ndoqi trajnimin në datat 22 dhe 23 janar 2025.



Përfundimi me sukses i "Trajnimit për Microsoft 365 Essential" shënon një hap të rëndësishëm përpara për përforcimin e kapaciteteve të INSTAT-it për punë më efikase dhe bashkëpunuese. Përmes pajisjes së personelit me aftësitë digjitale thelbësore, trajnimi jep kontribut për synimin e përgjithshëm të ngritjes së sistemit të qëndrueshëm statistikor në Shqipëri. Në mbyllje të trajnimit secilit prej pjesëmarrësve iu dha certifikata e pjesëmarrjes.

b) Në datat 23 dhe 24 dhjetor 2024, u organizua **seminari për rezultatet e të dhënave të Censit të të gjitha Zyrave Rajonale të Statistikave (ZRS).**

Sipas rendit të ditës, sa më poshtë ishin temat kryesore:

DITA 1	DITA 2
Roli i Zyrave Rajonale të Statistikave në shpërndarjen e rezultateve të Censit të vitit 2023.	Roli i Zyrave Rajonale të Statistikave në shpërndarjen e rezultateve të Censit të vitit 2023.
Metodologjia e mbledhjes së të dhënave dhe shpërndarja e rezultateve të hollësishme të Censit	Siguria kompjuterike dhe garantimi i saj në INSTAT
Rezultatet e Hollësishme të Censit në Rajonin Qendror - Profili i Qarqeve dhe Bashkive	Përmbledhja e veprimtarive kryesore të INSTAT-it gjatë vitit 2024, vështirësitë dhe angazhimet për vitin 2025 dhe roli i ZRS-ve.
Rezultatet e Hollësishme të Censit në Rajonin e Jugut - Profili i Qarqeve dhe Bashkive	
Rezultatet e Hollësishme të Censit në Rajonin Verior - Profili i Qarqeve dhe Bashkive	
Paraqitja e të dhënave të Censit përmes platformës së njës së të dhënave	
Paraqitja e të dhënave të Censit përmes platformës WebGIS	



c) Më 26 dhjetor 2024 u organizua seminari: Statistikat rajonale dhe paraqitja e tyre me anë të përbërësit geografik me personelin e selisë qendrore të INSTAT-it.

Sipas rendit të ditës, u trajtuan temat e mëposhtme:

- Bazat e të dhënave statistikore, Lidhësi PxWeb dhe siguria kompjuterike
- Paraqitja e të dhënave të Censit përmes platformës së njës së të dhënave
- Paraqitja e të dhënave të Censit përmes platformës WebGIS
- Diskutime



JU FALËNDEROJMË QË LEXUAT BULETININ TONË INFORMATIV!

EKIPI I SALSTAT

Menaxher projekti:

Martin Teichgräber, Zyra Federale Zvicerane e Statistikave

Koordinatorë:

Alketa Doçi, Koordinautore për Regjistrat dhe të Dhënat Administrative

Eralda Pushaj, Koordinautore me Njësitë e Qeverisjes Qendrore

Edlira Çeliku, Koordinautore Administrative dhe Financiare